RAPORTI I VITIT 2013 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një Kuvend njëdhomësh, i cili më pas e zgjedh një kryetar, Kuvendi duhet ta miratojë kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari. Vendi i mbajti zgjedhjet parlamentare në vitin 2010-11, të cilat përmbushën shumë standarde ndërkombëtare, por të cilat kishin gjithashtu shumë parregullsi, përfshirë blerjen e votave, kufizimin e pjesëmarrjes së gruas, posaçërisht në zonat rurale, dhe kufizimin e lirisë së lëvizjes për pakicat etnike. Vendi e shpalli pavarësinë e vet nga Serbia në vitin 2008. Autoritetet civile mbajtën kontrollin mbi forcat e sigurisë. Pati disa raportime që Policia e Kosovës (PK) i ka abuzuar të drejtat e njeriut.

Në korrik, NATO deklaroi aftësi të plotë operacionale për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), duke i dhënë fund autoritetit ekzekutiv të Forcës së NATO-s për Kosovën (KFOR), të autorizuat nga OKB-ja. Mandati i Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) ishte paraparë të përfundonte në gjysmën e vitit 2014. EULEX-i e monitoron PK-në dhe sektorin e drejtësisë në një kapacitet të kufizuar. Më 19 prill, Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë nënshkruan një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve përmes një dialogu të lehtësuar nga BE-ja. Të dy qeveritë punuan së bashku për ta zbatuar këtë dhe marrëveshje të mëhershme mbi menaxhimin e integruar të kufirit, lirinë e lëvizjes dhe regjistrat civilë. Më 11 korrik, si pjesë e marrëveshjes së prillit, kuvendi miratoi ligjin për amnistinë, i cili fal një numër të krimeve të kryera para 20 qershorit dhe inkurajon integrimin e mëtejmë të qytetarëve të veriut. Presidentja Atifete Jahjaga e dekretoi këtë ligj më 17 shtator. Më 3 nëntor, zgjedhjet komunale, të cilat u mbajtën në tërë vendin, përfshirë Kosovën veriore, ishin një element i rëndësishëm i marrëveshjes së prillit për normalizimin e marrëdhënieve

Problemi më i theksuar i drejtave të njeriut gjatë vitit u përqendrua në përpjekjet e ekstremistëve serbë të Kosovës për ta bllokuar normalizimin, përfshirë vendosjen e barrikadave në pjesën veriore të vendit dhe kufizimin e të drejtave themelore si lirinë e lëvizjes së personave dhe mallrave. Ekstremistët dhe elementët kriminalë gjithashtu përdorën dhunën dhe kërcënimin kundër kundërshtarëve të brendshëm dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë, përfshirë vrasjen e një pjesëtari të EULEX-it në shtator. Gjatë zgjedhjeve komunale të nëntorit, sulmuesit hynë dhe plaçkitën tri qendra të votimit në veri, duke e bërë të nevojshëm rivotimin dy javë më vonë. Dhuna dhe diskriminimi shoqëror ndaj bashkësive pakicë, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve (LHBT) përbënte fushën e dytë të shqetësimit të madh. Dhuna në familje ndaj femrave ishte problemi i tretë kryesor.

Në probleme të tjera të të drejtave të njeriut përfshiheshin keqtrajtimi i të ndaluarve nga policia, dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni dhe favoritizmi në burgje, kushtet fizike nën standarde në burgje, paraburgimi i gjatë dhe joefikasiteti i gjyqësorit, kërcënimi i medieve nga zyrtarët publikë dhe elementët kriminelë, kufizimet mbi lirinë fetare dhe vandalizmi mbi baza fetare, përparimi i kufizuar në kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit në shtëpitë e tyre, dhuna dhe parregullsitë në zgjedhje lokale në disa zona, korrupsioni në Qeveri, retorika antisemitike, trafikimi i personave, kushtet e dobëta në objektet e shëndetit mendor, tensionet sporadike etnike në veri dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime, qoftë në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri, ndonëse shumë veta mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion dhe vepronin pa u ndëshkuar.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme gjatë vitit. Asnjë organizatë qeveritare nuk përcaktoi nëse vrasjet nga forcat e sigurisë, kur ndodhnin, ishin të justifikueshme. Në shumicën e institucioneve qeveritare, sektorët për çështje të brendshme i hetonin vdekjet që lidheshin me forcat e sigurisë dhe mund t'i rekomandonin rastet specifike në sistemin e gjykatave.

Më 19 shtator, sulmues të paidentifikuar shtinë në një veturë të EULEX-it që bartte zyrtarë doganorë gjersa ishte duke udhëtuar afër komunës së Zveçanit, me ç'rast u vra një pjesëtar lituanez i EULEX-it dhe një udhëtar tjetër u lëndua.

Fletarrestimet ndërkombëtare të lëshuara nga EULEX-i për të dyshuar për vrasjen në vitin 2011 të policit Enver Zymberi mbetën aktive, por zyrtarët nuk arrestuan askënd apo nuk ishte bërë përparim në zgjidhjen e rastit. EULEX-i i pezulloi hetimet në mars.

Gjatë vitit, Qeveria bashkëpunoi me Task Forcën e EULEX-it për Hetime Speciale (SITF) për t'i hetuar pohimet për krime të rënda të kryera ndërmjet korrikut të vitit 1999 dhe mesit të vitit 2000 nga pjesëtarët e UÇK-së, forcës guerile shqiptare që e udhëhoqi luftën e vendit për pavarësi, dhe bashkëpunëtorët e tyre. Abuzimet e supozuara, të theksuara në një raport të Këshillit të Evropës, përfshinin mbajtjen e personave në kushte çnjerëzore dhe vrasjen e civilëve për trafikim të organeve të tyre jashtë vendit. Zyrtarë të lartë qeveritarë ripohuan mbështetjen e tyre në hetim gjatë një vizite të SITF-it dhe hetimi vazhdoi në fund të vitit.

Më 17 shtator, një trup gjykues i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendës i liroi anëtarin e Kuvendit Fatmir Limaj dhe nëntë të tjerë nga akuzat për krime lufte lidhur me qendrën e ndalimit në Kleçkë të drejtuar nga UÇK-ja në vitin 1999, ku të ndaluarit u keqtrajtuan dhe shtatë serbë të Kosovës u vranë.

Si pjesë e një hetimi të EULEX-it lidhur me ngjarjet në një qendër ndalimi të UÇK-së afër Skenderajt, autoritetet ngritën aktakuzë kundër 15 ish-pjesëtarëve të UÇK-së për krime lufte gjoja të kryera gjatë konfliktit të vitit 1998-99. Grupi i Drenicës, siç njiheshin, përfshinte zyrtarë qeveritarë që kishin lidhje të forta me partinë në pushtet, si ambasadori i vendit në Shqipëri, Sylejman Selimi, dhe kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku. Zyrtarët e akuzuan Selimin me shtatë pika të aktakuzës që lidheshin me kohën e tij si kryekomandant i UÇK-së, përfshirë keqtrajtimin e civilëve dhe përdorimin e dhunës kundër së paku një dëshmitari të mbrojtur. Prokurorët e akuzuan Lushtakun për vrasjen e një civili shqiptar të Kosovës dhe Sahit Jasharin për vrasjen e policit serb Ivan Bullatoviq. Në nëntor, prokurorët ngritën veçmas padi për krime lufte kundër Selimit dhe tre të tjerëve për torturë dhe abuzim të dy shqiptareve kosovare në vitin 1998-99

Më 19 korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës e dënoi Nazim Bllacën me 4.5 vjet burg për vrasje të rëndë të ish-zyrtarit të lartë të Sigurimit Shtetëror Jugosllav, Ibush Kllokoqi, në vitin 1999. Bllaca – një vrasës i vetërrëfyer – e pranoi fajin. Sipas gjykatës, paraqitjet e Bllacës si dëshmitar bashkëpunues në dy gjykime të mëhershme e zbutën dënimin e tij.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje ose rrëmbime me motive politike.

Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), 1.723 persona ende gjendeshin në listën e personave të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99. Kufizimet e KNKK-së për konfidencialitet nuk lejojnë konfirmim, por vëzhguesit sugjeruan që rreth 70 për qind e tyre ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind ishin serbë të Kosovës dhe pakica të tjera. Të afërmit e personave të zhdukur rregullisht shprehnin frustrim në hapin e ngadalshëm të përparimit dhe u bënin thirrje autoriteteve në Kosovë dhe Serbi që t'i dyfishonin përpjekjet e veta për t'i gjetur personat e tjerë.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë praktika të tilla, por disa vëzhgues ndërkombëtarë raportuan se në vitin 2010 autoritetet përdorën masa të ashpra kundër të burgosurve. Ata theksuan se përmirësimet vazhduan në praktikat administrative dhe në lehtësirat fizike.

Gjatë vizitës që i bëri vendit në vitin 2010, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT)) pranoi nga personat që ishin ndaluar gjatë vitit pretendime për keqtrajtim fizik nga policët. Pretendimet kishin të bënin kryesisht me goditje me grushte, shqelma dhe shkopinj gjatë arrestimit të tyre. KPT gjithashtu raportoi se disa policë përpiqeshin të merrnin deklarata nga ta gjatë marrjes në pyetje duke i goditur me shuplaka, grushte, shqelma (përfshirë gjenitalet), duke i goditur personat me objekte të forta, duke ua shtypur dorën me laps të vendosur ndërmjet dy gishtave dhe duke i rrahur të burgosurit në tabanë të këmbëve. KPT konkludoi se në disa raste ashpërsia e keqtrajtimit të supozuar "lehtë do të mund të cilësohej si torturë". Sipas KPT-së, dukej që "gjendja sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria nga PK-ja ka stagnuar, nëse nuk është përkeqësuar" që nga vizita e vet në vitin 2007.

Raportet e vëzhguesve vendorë, të cilët bënin vizita të rregullta periodike, përfshirë Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Qendrën e Kosovës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), gjetën vetëm ankesa të izoluara dhe treguan që keqtrajtimi i të burgosurve dhe i të ndaluarve vazhdimisht kishte shënuar rënie viteve të fundit. Zyra e Avokatit të Popullit i kishte marrë tri raporte për gardianë të burgut që i kishin abuzuar të ndaluarit apo të burgosurit gjatë nëntë muajve të parë të vitit.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), një organ i pavarur brenda Ministrisë të Punëve të Brendshme, i hetoi pesë raste në të cilat policët gjoja i keqtrajtuan pjesëmarrësit gjatë protestave të janarit të vitit 2012 që kishin për qëllim t'ua ndalonin veturave komerciale serbe hyrjen në vend. IPK-ja i dërgoi katër raste në Njësinë e PK-së për Standarde Profesionale (NJSP) për masa disiplinore dhe një prokurorit, i cili ngriti aktakuzë. Gjykata nuk kishte vendosur në atë rast deri në fillim të nëntorit.

Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit

Kushtet e burgjeve dhe qendrave të ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare, por pati probleme të mëdha në disa institucione. Në këto probleme përfshiheshin lehtësirat e mangëta, dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni dhe kujdesi mjekësor nën standarde. Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut.

Kushtet fizike: Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) i udhëhoqi punët ditore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të ndalimit. EULEX-i mbajti rol të kufizuar monitorues, mentorues dhe këshillues në burgje dhe i transportonte të burgosurit sipas kërkesës. Më 15 nëntor, qendrat korrektuese patën 1.093 të burgosur të dënuar dhe 602 të paraburgosur të përzier në burgje dhe qendra të ndalimit. 54 femra, 37 të mitur dhe 92 shtetas të huaj ishin në burgje dhe qendra të ndalimit. SHKK raportoi për vdekjen e katër të burgosurve gjatë vitit, të gjithë nga shkaqet natyrore. Qendrat korrektuese në vend mund ta menaxhojnë një popullatë prej përafërsisht 2.000 personash. Tri qendra korrektuese gjashtë qendra të ndalimit, një qendër për mbrojtje të dëshmitarëve dhe një spital i burgut punuan gjatë vitit.

Avokati i Popullit, QKRVT-ja dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut bashkërisht konkluduan se kushtet në disa zona dhe në disa objekte mbetën nën standarde Të metat përfshinin ndriçimin apo ventilimin e dobët në disa qeli, kuzhinat dhe tualetet e vjetruara, mungesën e ujit të nxehtë dhe shtrojat joadekuate ose mungesën e tyre në disa burgje dhe qendra të ndalimit. Sipas QKRVT-së, numri i të burgosurve dhe i të ndaluarve në shumicën e qendrave të ndalimit shënoi rënie gjatë vitit, me përjashtim në Gjilan, Prishtinë dhe Prizren, ku numri i të burgosurve mbeti i lartë.

Zyrtarët korrektues e përshkruan mbingarkesën si problem të vogël sezonal që u përkeqësua gjatë muajve të ftohtë pasi shumë individë që kishin kryer krime të vogla kërkonin ta vuanin dënimin e tyre prej tre deri në gjashtë muaj gjatë dimrit, kur koha e kaluar larg punëve bujqësore ka ndikim më pak negativ në të ardhurat familjare. Autoritetet korrektuese u përpoqën t'i akomodonin kërkesat e tilla.

QKRVT-ja identifikoi mangësi të mëdha në sistemin e kujdesit shëndetësor në burgje, si numrin e pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor, furnizimin e parregullt me barëra, vonesat në ofrimin e trajtimit mjekësor për të burgosur dhe të ndaluar dhe mungesën ose vonesën e trajtimit të mirëfilltë të përdoruesve të drogës. Sipas QKRVT-së, pjesa më e madhe e dërgesave të kujdesit shëndetësor ishte joadekuate, por furnizimi me disa barëra themelore mbeti problem. Në disa raste, kushtet i detyronin të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme përmes burimeve private. Në prill, qeveria miratoi një ligj të ri për shëndetin, i cili përgjegjësinë për kujdesin shëndetësor në burgje e barti prej Ministrisë së Drejtësisë tek Ministria e Shëndetësisë. Zyrtarët e SHKK-së e mirëpritën këtë kalim të përgjegjësive pjesërisht për shkak të besimit që Ministria e Shëndetësisë kishte më tepër burime dhe ekspertizë se Ministria e Drejtësisë.

Në vitin 2010, KPT vuri në pah se kushtet fizike në stacionet policore të vendit ishin përmirësuar që nga vizita e vet në vitin 2007, por KPT gjithashtu konkludoi që dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni dhe favoritizmi ishin probleme endemike në Dubravë

dhe institucione të tjera ndëshkimore. Avokati i Popullit konfirmoi se kushtet në spitalin e burgut të Dubravës ishin të këqija.

Administrata: Zyrtarët mbanin shënime për të burgosurit, por administratorët pohonin se ndarja e autoritetit që i jep përgjegjësi për të burgosurit e dënuar SHKK-së dhe përgjegjësi për të burgosurit e dënuar sistemit gjyqësor shkaktonte probleme. P.sh., autoritetet e burgut nuk mund të intervenonin kur të paraburgosurit me lidhje të mira i përdornin lidhjet gjyqësore për t'u transferuar në lehtësira më komode në spitalin e Prishtinës, madje edhe kur burgu ua ofronte shërbimet përkatëse mjekësore.

Autoritetet u lejonin vizita të burgosurve dhe ua lejonin ceremonitë fetare, përfshirë të drejtën për të kërkuar vizita nga klerikët. Burgjet dhe qendrat e ndalimit ofronin meny të modifikuara për ceremoni fetare, përfshirë agjërimet/kreshmët fetare.

Të ndaluarit mund t'u paraqitnin ankesa dhe kërkesa për hetime autoriteteve gjyqësore dhe Zyrës së Avokatit të Popullit, pa censurim, përmes kutive anonime në shumicën e burgjeve. Në nëntë muajt e parë të vitit, të burgosurit ia kishin parashtruar 128 ankesa Avokatit të Popullit.

Përmirësimet: Ministria e Drejtësisë dhe SHKK-ja bënë disa përmirësime të mëdha gjatë vitit, duke filluar me zëvendësimin e tre zyrtarëve të lartë në Qendrën Korrektuese të Dubravës. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të SHKK-së raportoi se administrata e re e kësaj qendre filloi t'u ofronte mbrojtje dëshmitarëve të rrezikuar në një ndërtesë të ndarë dhe filloi zbatimin e rregullave të ashpra për të burgosurit e rrezikut të lartë. Zyrtarët gjithashtu raportuan për përfundimin e renovimeve në pavijonin 3 të Dubravës dhe në kuzhinën e burgut dhe nënshkroi tenderë për punë të ngjashme në pavijonet 5 dhe 7. Të burgosurit me aftësi të kufizuara do të akomodohen në pavijonin 7. Zyrtarët nuk raportuan për lëndime të mëdha të të burgosurve nga dhuna ndërmjet të burgosurve gjatë 10 muajve të parë të vitit.

Më 30 tetor, autoritetet e transferuan dëshmitarin e mbrojtur Shkumbin Mehmeti nga Burgu i Dubravës në spitalin rajonal të Pejës pasi të burgosur të tjerë e sulmuan atë fizikisht gjersa ishte nën mbrojtje. Thuhej që Mehmeti kishte informata lidhur me disa vrasje politike të profilit të lartë pas lufte.

SHKK gjithashtu raportoi se kishte investuar 600.000 euro ($810.000) në qendrën korrektuese në Mitrovicën veriore dhe dukshëm i kishte përmirësuar kushtet për 60 punëtorët e vet dhe të burgosurit, që në shator ishin 23.

Më 18 dhjetor, Qeveria hapi një burg të ri të sigurisë së lartë në Podujevë, të ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare, me një kapacitet prej 300 të burgosurve. 130 zyrtarë korrektues ia filluan punës në këtë burg pas përfundimit të trajnimit themelor 10-javor.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurisë

Forcat vendëse të sigurisë përfshijnë PK-në dhe FSK-në. Ligji parashikon që policia të funksionojë nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. EULEX-i funksiononte nën mandatin për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet lokale të gjyqësisë dhe të zbatimit të ligjit. Policia e EULEX-it gjithashtu kishte përgjegjësi operative dhe kreu operacione policore sipas mandatit të përcaktuar. EULEX-i posedonte autoritet të kufizuar ekzekutiv në disa fusha, përfshirë krimin e organizuar, korrupsionin, krimet e luftës, mbrojtjen e dëshmitarëve, shpëlarjen e parave, financimin e terroristëve dhe bashkëpunimin policor ndërkombëtar. FSK-ja është forcë civile e reagimit, me armatim të lehtë, e mentoruar nga KFOR-i, që funksionon nën autoritetin civil të Ministrisë së FSK-së.

Policët ndërkombëtarë të EULEX-it i plotësuan me personel njësitë e specializuara policore për hetimin e krimeve të luftës, krimeve financiare, krimit të organizuar dhe programin e policisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili vepronte në mënyrë të pavarur nga PK-ja. EULEX-i dhe PK-ja në mënyrë të pavarur drejtonin njësitë për zbulim penal dhe krim të organizuar. Policët, prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it, të stacionuar në tërë vendin, kishin diskrecion të gjerë për të intervenuar në cilëndo çështje të veçantë penale, por policia vendëse mbajti shumicën e detyrave dhe përgjegjësive policore.

Në tetë muajt e parë të vitit, IPK-ja i shqyrtoi 682 ankesa për sjellje të policëve, përfshirë shkeljet e vogla disiplinore, përdorimin e tepërt të dhunës, abuzimin e autoritetit, sjelljen e pahijshme dhe veprat kriminale. Prej rasteve që mendonte se duhej të shqyrtoheshin më tej, IPK-ja ia përcolli NJSP-së 484 raste që cilësoheshin si shkelje disiplinore. Ajo i cilësoi 155 raste të tjera si raste penale. Ajo fillimisht nuk i paraqiti pesë raste të tjera ku përfshiheshin shkelje disiplinore të profilit të lartë për shqyrtim të mëtejmë, por në shtator ia përcolli një prej tyre policisë për masa të brendshme disiplinore dhe i mbylli katër të tjerat për shkak të mungesës së provave.

NJSP hetoi kundërvajtjet e vogla të policëve dhe shqiptoi ndëshkime administrative për kundërvajtje. Gjatë vitit, njësia hapi 1.235 raste, përfshirë rastet e mosbindjes së vogël dhe dëmtimit apo humbjes së pronës policore. Në shtator, 303 raste mbetën në hetim e sipër.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

Në janar, Kuvendi miratoi Kodin e ri Penal dhe Kodin e ri të Procedurës Penale, të cilët prezantuan ndryshime të mëdha ligjore. Ligji i rishikuar parashikon që policia mund të arrestojë persona duke përdorur urdhrat e bazuar në prova dhe të lëshuar nga gjyqtari ose prokurori, përveç kur has në një krim që është në zhvillim e sipër. Ligji i ri kërkon që prokurorët të ngrenë padi ndaj personave që i arrestojnë brenda gjashtë orësh në gjuhën që e kuptojnë. Autoritet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjyqtarit brenda 48 orësh ose t'i lirojnë. Ligji i rishikuar kërkon nga autoritetet që t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin mbrojtës të cilin e zgjedhin apo t'ua sigurojnë një avokat. Ai gjithashtu u mundëson të dyshuarve të heshtin dhe të mos u përgjigjen pyetjeve, përveç pyetjeve për identitetin e tyre, për ndihmë falas të përkthyesit, dhe për trajtim mjekësor dhe psikiatrik. Policia nuk mund t'i mbajë të dyshuarit pa mundësi komunikimi.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit dhe mund ta vazhdojë ndalimin deri në një vit pa aktakuzë. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjyqtari gjykues apo trupi gjykues mund ta urdhërojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon arrestin shtëpiak, nëse urdhërohet nga gjyqtari, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzanisë si alternativa ndaj paraburgimit. Të pandehurit gjithashtu mund të ankohen për paraburgimin e tyre dhe Kodi i ri Penal dhe Kodi i ri i Procedurës Penale u lejojnë të ndaluarve të paraqesin ankesa për ta kontestuar ligjshmërinë ose kushtet e paraburgimit të tyre. Të pandehurit e ndaluar në mënyrë të paligjshme gjithashtu mund të paraqesin padi për kompensim.

Shumica e arrestimeve kryheshin në përgjithësi nga policia, në disa raste nga policë të maskuar apo sekretë, duke përdorur urdhërarrestin. Nuk pati raportime që policia e abuzoi rregullin 48-orësh dhe prokurorët e shtetit në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar shkresa në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, por QKRVT-ja raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët nuk ishin në dispozicion deri në mëngjes pas ndalimit të personit. Gjykatat rrallë herë e përdorën dorëzaninë.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit, por vetëm në fillim të marrjes së tyre në pyetje nga policët hetues. Në disa raste, zyrtarët gjoja u mundësuan të ndaluarve qasje në avokat por vetëm pas marrjes formale në pyetje dhe disa të ndaluar ankoheshin se kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë edhe pse kishin kërkuar avokat menjëherë pas arrestimit të tyre.

Ndonëse të ndaluarit kanë të drejtë t'i njoftojnë anëtarët e familjes për ndalimin e tyre, KPT theksoi në raportin e vet të vitit 2010 se respektimi i kësaj të drejte nga autoritetet në përgjithësi ishte keqësuar që nga vizita e vet në vitin 2007. KPT-ja raportoi se një numër i personave të ndaluar ankoheshin se policia i njoftonte anëtarët e familjes për arrestimin e tyre vetëm nga fundi i kohës së tyre në ndalim policor. KPT-ja i konfirmoi pretendimet e të ndaluarve përmes ekzaminimit të regjistrave dhe të dhënave të ndalimit në disa prej stacioneve policore që i kishte vizituar.

Në rrethana të jashtëzakonshme, KFOR-i mund t'i arrestojë dhe ndalojë individët pa urdhërarrest. Komandanti i KFOR-it mund t'i ndalojë individët për 72 orë dhe ta vazhdojë atë edhe për 72 orë të tjera. Pas 144 orësh, KFOR-i duhet ta lirojë të ndaluarin. Nuk pati raportime që KFOR-i kishte arrestuar persona pa urdhërarrest gjatë këtij viti.

Më 7 janar, krishtlindjet ortodokse serbe, policia i arrestoi 10 serbë të Kosovës nga Leposaviqi në komunën e Graçanicës për hyrje ilegale në vend të cilët e identifikuan veten si "nga Serbia". Policia vërejti që grupi e përcillte eskortën policore të një zyrtari serb gjatë vizitës së lejuar të atij zyrtari në një manastir në komunë. Prokurori publik urdhëroi paraburgimin e të 10 personave për 48 orë nën akuzën për pengim të personit zyrtar. Policët e Njësisë për Operacione Speciale të Policisë së Kosovës i transferuan të paraburgosurit në qendrën e paraburgimit në Prishtinë. Pas lirimit të tyre, më 10 janar, të paraburgosurit pohuan se policia i kishte rrahur dhe përqeshur në shumë raste gjersa ishin në paraburgim. Një prej tyre, Darko Vasaj, pohoi se posaçërisht ai ishte shënjestër e policëve pasi ishte i lindur nga

një martesë e përzier shqiptaro-serbe dhe e qëllonin ndërmjet këmbëve gjersa e shoqëronin për në tualet, duke i shkaktuar lëndime të rënda. Më 12 dhjetor, prokurorët e Prishtinës, në koordinim me EULEX-in, ngritën një sërë akuzash për sulm, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës dhe kanosje kundër 11 policëve të implikuar në incident.

Paraburgimi: Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji lejon që gjykatësi ta shqiptojë masën e paraburgimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi që ka kryer vepër penale ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat; të ndikojë në dëshmitarë; të ikën; ta përsërisë veprën penale apo të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova.

Ndalimi i gjatë ishte problem i veçantë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përkohësisht me seli në Vushtrri. Autoritetet rregullisht e kanë vazhduar paraburgimin e të pandehurve që pritnin gjykimin gjatë tërë kohës që gjykata punonte me kapacitet të kufizuar. Në gusht, 597 persona në këtë qark mbetën në paraburgim duke pritur që gjykata t'i shqyrtonte rastet e tyre. Me përjashtim të kësaj gjykate, shumë rrallë ndodhte që paraburgimi ta tejkalonte dënimin e paraparë për krimin e supozuar të të ndaluarit.

Joefikasiteti i gjyqësorit dhe korrupsioni ishin ndër faktorët që shkaktonin shtyrjen e gjykimeve.

Falja: Më 17 shkurt, Presidentja fali katër individë për nderë të përvjetorit të pestë të pavarësisë së vendit..

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjyqësi të pavarur, por gjyqësia nganjëherë ishte e njëanshme, i nënshtrohej ndikimit të jashtëm dhe ndikimit politik dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Pati raportime për korrupsion në gjyqësi dhe sistemi i gjykatave mbeti joefikas. U themelua një mekanizëm efikas për procedura disiplinore kundër gjykatësve dhe prokurorëve. Autoritetet në përgjithësi i respektuan urdhrat e gjykatave.

EULEX-i e ushtroi autoritetin e vet ekzekutiv mbi një prokurori speciale që fokusohej në krime të rënda, përfshirë trafikimin e personave, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin. 27 gjykatës ndërkombëtarë, të punësuar përmes EULEX-it, i mbështetnin gjykatësit vendës. Në rastet penale në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it e ushtronin juridiksionin, gjykatësit e EULEX-it shërbenin në kolegje të përziera me gjykatës vendës. Gjykatësit e EULEX-it ishin shumicë në këto kolegje, me një gjykatës të EULEX-it që shërbente si kryetar i kolegjit. Për rastet civile në të cilat gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it e ushtronin juridiksionin, kolegjet gjyqësore përbëheshin prej tre gjykatësve, dy prej tyre ishin gjykatës të EULEX-it.

Më 18 qershor, një kolegj i përzier gjyqësor e dënoi ish-Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj, me 18 muaj burg dhe me një gjobë për falsifikim të dokumenteve zyrtare dhe shmangie të tatimit. Gjykata gjithashtu ia ndaloi Tolajt ushtrimin e funksioneve në administratë publike ose në shërbim publik për tri vjet. Një prokuror special i EULEX-it e gjykoi rastin.

Më 23 maj, një kolegj i përzier në Gjykatën Themelore të Pejës e gjykoi ish-prokurorin Nazmi Mustafi për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe posedim të paautorizuar të armëve dhe e dënoi me pesë vjet burg dhe me një gjobë. Gjykata i shpalli dy persona të tjerë në këtë rast fajtorë për ushtrim të ndikimit dhe nxitje për shpërdorim të detyrës zyrtare.

Më 19 qershor, një kolegj i përzier e liroi Zëvendëskryeministrin Bujar Bukoshi nga akuzat për shpërdorim të detyrës dhe autoritetit zyrtar në rastin e korrupsionit në Ministrinë e Shëndetësisë.

Më 28 shkurt, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi ish-ministrin për Komunitete dhe Kthime, Branisllav Gërbiq, dhe tetë ish-bashkëpunëtorë me 7,5 vjet burg për përvetësim të 1,1 milionë eurove ($1,5 milionë) in 2006. Gjykata e liroi ish-ministrin tjetër për Komunitete dhe Kthime, Sllavisha Petkoviq, për shkak të mungesës së provave dhe deklaratave kontradiktore të dëshmitarëve. Akuzat buronin nga viti 2006 kur anëtarët e grupit kishin falsifikuar kontrata dhe dokumente të tjera.

Qeveria serbe vazhdoi ta drejtonte një sistem paralel ilegal të gjyqësisë në komunat me shumicë serbe gjatë nëntë muajve të parë të vitit, por ndaloi së marri raste të reja më 1 tetor si pjesë e procesit për zbatimin e marrëveshjes për normalizim.

Procedurat e gjykimit

Ligji parashikon gjykime të drejta dhe të paanshme dhe gjyqësori në përgjithësi e respektoi ligjin. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzën, të drejtën për të qenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin, të mos detyrohen të dëshmojnë apo ta pranojnë fajin, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor.

Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Vendi nuk mban gjykime me juri. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim.

Komisioni për Ndihmë Juridike, një agjenci e pavarur qeveritare, u ofroi ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta. Pjesa më e madhe e ndihmës së ofruar nga Komisioni gjatë vitit ishte për çështje civile ose administrative. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit drejtonte një sektor për avokatë të viktimave, që u ndihmonte viktimave të krimit për të pasur qasje në drejtësi. Ky sektor u ofronte ndihmë juridike falas viktimave të të gjitha krimeve me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimit të personave, abuzimit të fëmijës dhe dhunimit. Ky sektor drejtonte 15 zyra në tërë vendin dhe ofronte ndihmë 24 orë në ditë.

Ministria e Drejtësisë drejtonte sektorin për integrim gjyqësor, i cili i shqyrtonte problemet që ndikonin në pakica. Ministria drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave për t'u ndihmuar bashkësive pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe duke i shoqëruar në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre dhe duke u siguruar refugjatëve dhe personave të zhvendosur informata dhe ndihmë juridike.

EULEX-i mbikëqyr rastet e krimeve të luftës. EULEX-i mund t'i hetojë dhe gjykojë rastet vetëm apo, kur është nevoja, bashkë me homologët kosovarë. Në shtator, EULEX-i ishte duke i hetuar 94 raste për krime lufte dhe duke i gjykuar katër raste për krime lufte.

Më 12 shtator, një kolegj i EULEX-it i dënoi Sabit Gecin, Rrustem Gecin dhe Hetem Gecin me nga 12 vjet burg për krime lufte kundër popullatës civile dhe vrasjen e Gani Berishës në vitin 1999.

Në mars, Kuvendi mbajti një debat lidhur me rastin Kiçina, ndonëse sistemi i drejtësisë kishte mbaruar punën e vet dhe kishte nxjerrë vendimin e vet përfundimtar. Rasti Kiçina përshinte vrasjen e një shqiptari dhe të familjes së tij në vitin 2001 nga persona të cilët dyshonin që ai bashkëpunonte me forcat serbe. Pas presionit të madh nga jashtë, Kuvendi u pajtua të heqë dorë nga krijimi i një komisioni *ad hoc* për hetimin e mëtejmë të rastit të përfunduar.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime që Qeveria mbante të burgosur apo të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Nuk pati mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut. Individët iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Ndonëse vendi nuk është nënshkrues i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetuta në mënyrë të qartë i përfshin standardet e Konventës dhe individët mund ta parashtrojnë në Gjykatë Kushtetuese shkeljen e Konventës.

Në shkurt, Gjykata Kushtetuese vendosi që Gjykata Komunale e Prishtinës ia kishte shkelur Diana Kastratit të drejtën për jetë kur ia kishte mohuar kërkesën e saj në vitin 2011 për mbrojtje nga bashkëshorti i saj, i cili më vonë e rrahu për vdekje. Gjykata Kushtetuese gjithashtu gjeti që Gjykata Komunale i kishte shkelur të drejtat e Kastratit sipas dispozitave e drejta për jetën dhe e drejta për zgjidhje efektive të Konventës Evropiane. Në gusht, autoritetet spanjolle e arrestuan Adnan Kastratin lidhur me vdekjen e bashkëshortes së tij, por mungesa e marrëveshjes për ekstradim e pengoi kthimin e tij në vend.

Rikthimi i pronës

Qeveria vazhdoi të shënonte përparim në zgjidhjen e rasteve për rikthimin e pronës. Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë e ndërlikonin zgjidhjen e rasteve të të drejtave pronësore.

Komisioni për kërkesa pronësore i Kosovës, i cili vepron në kuadër të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), i vlerëson kërkesat që dalin nga konflikti i Kosovës. Deri në shtator, Komisioni kishte shqiptuar vendime për 42.457 kërkesa prej gjithsej 42.515 kërkesave të regjistruara dhe i kishte njoftuar 35.053 parashtrues të kërkesave për konkluzionet e veta. Në të njëjtën kohë, AKP-ja raportoi se 13.000 vendime të saj nuk ishin zbatuar. Sekretaria

Ekzekutive e AKP-së pranoi 648 ankesa kundër vendimeve të tyre gjatë nëntë muajve të parë të vitit dhe i referoi 380 sosh në Gjykatën Supreme për masa të mëtejme.

AKP përjetoi vështirësi në zbatimin e vendimeve të veta gjatë dëbimit të banorëve të paligjshëm, posaçërisht në Mitrovicën veriore ku serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës shpesh refuzonin t'i lironin pronat që ligjërisht u takonin anëtarëve të grupit tjetër. Agjencia më shpesh i referonte rastet e "rizënies serike" (në të cilën banorët e dëbuar ktheheshin për të jetuar në pronat që ligjërisht nuk ishin të tyre) në prokurori dhe polici për masa të mëtejme.

AKP-ja kishte mungesë të fondeve të nevojshme për kompensim për t'i zgjidhur 143 rastet e vendosura nga Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore në favor të parashtruesve të kërkesave që i kishin humbur pronat e tyre ë fillim të viteve 1990 për shkak të praktikave diskriminuese sistematike banesore që zbatoheshin në atë kohë.

Numri i pazgjidhur i kërkesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë, rreth 20.000 në fund të vitit, që ishin pothuaj vetëm kërkesa financiare të serbëve të Kosovës për pronën e pabanueshme të dëmtuar nga lufta. Vendit i mungonte një sistem efektiv dhe efikas për t'u mundësuar rreth 200.000 serbëve të zhvendosur nga Kosova për të paraqitur kërkesa pronësore dhe kërkesa të tjera nga Serbia.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë. Forcat e KFOR-it mbajtën mundësinë, në bazë të autoritetit paqeruajtës të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për t'i ndihmuar policisë vendëse dhe policisë së EULEX-it në kryerjen e kontrollimeve për të dyshuar të rrezikut të lartë dhe në mënyrë të pavarur për ta kontrolluar pronën private për armë, pa urdhër të gjykatës,. KFOR-i nuk kreu asnjë kontrollim të tillë gjatë vitit.

Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, pati raportime që përfaqësuesit e medieve ishin kërcënuar nga zyrtarë publikë, politikanë dhe biznese. Mediet gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, këtë e përkeqësoi edhe më tepër dështimi i Qeverisë për ta emëruar një zëdhënës që nga viti 2010.

Kushtetuta parashikon një Komision të Pavarur për Media (KPM), një organ i pavarur përgjegjësitë parësore të të cilit janë t'i rregullojë frekuencat e transmetimit, t'u lëshojë leje transmetuesve publikë e privatë dhe të përcaktojë e zbatojë politika transmetuese. Në shumë raste gjatë vitit, Kuvendi votoi për komisionarë të mundshëm, por nuk ia dilte të zgjidhte kandidatë të mjaftueshëm. Si rrjedhojë, KPM-ja funksiononte më mënyrë joefikase me një panel të pakompletuar.

Liria e shtypit: Mediet e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim; megjithatë, pati raportime për presion verbal ndaj pronarëve të

medieve nga zyrtarët qeveritarë dhe bizneset e lidhura me Qeverinë për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Vështirësitë financiare bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk i medieve të shkruara dhe elektronike t'i nënshtrohej ndikimit dhe presionit të jashtëm.

Disa medie të shkruara ishin financiarisht të pavarura dhe ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga interesat politike apo të biznesit. Mediet e tjera me më pak resurse nganjëherë pranonin ndihmë financiare nga një sërë burimesh në shkëmbim për raportim pozitiv apo për mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve.

Mediet transmetuese kishin qasje në një bazë më të madhe të të hyrave sesa mediet e shkruara. Publiku i perceptonte mediet transmetuese si më të pavarura, por stacionet e vogla raportonin se vazhdimisht ishin në rrezik të mbylljes dhe gjithnjë e më shumë vareshin nga burimet e jashtme të financimit për ekzistimin e tyre.

Kuvendi e kontrollon buxhetin e transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Ligji parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të RTK-së, përfshirë kohën qendrore, t'u kushtohet bashkësive pakicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale.

RTK2 filloi të transmetimin më 3 qershor, pas më tepër se një viti pasi Kuvendi e kishte miratuar legjislacionin për themelimin e kanalit të dytë të televizionit publik. Ligji parashikonte që RTK2 të transmetonte së paku 15 për qind të përmbajtjes së vet në gjuhët e pakicave joserbe. RTK2 transmetohej vetëm përmes kompanive kabllore pasi nuk kishte leje për transmetim në frekuenca tokësore.

Më 5 qershor, një kolegj i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it dhe vendorë i liroi nga akuza kryetarin e Skenderajt Sami Lushtaku dhe të bashkëpandehurit e tij pasi kishte vendosur që veprat me të cilat prokurorët i kishin akuzuar ata nuk ishin krime. Prokurorët i kishin akuzuar kryetarin dhe të pandehurit e tjerë për kërcënim të vazhdueshëm të Jeta Xharrës, drejtore e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), dhe për një fushatë të kërcënimit kundër saj dhe një anëtari të stafit të saj për shkak të një raportimi të BIRN-it në vitin 2009 për aktivitetet e tyre. Xharra ushtroi ankesë kundër këtij vendimi, por nuk mori asnjë përgjigje nga gjykata deri në fund të nëntorit. Një ditë para se gjykata ta lëshonte aktvendimin e vet, Lushtaku e kishte shkelur procedurën gjyqësore duke identifikuar dhe bërë akuza nxitëse kundër një dëshmitari të mbrojtur të këtij gjykimi. Ai e akuzoi dëshmitarin se ishte përgjegjës për ndjekjen e tij penale dhe për një sërë ndjekjesh penale për krime lufte të ngritura nga EULEX-i kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së.

Më 4 shtator, prokurorë të EULEX-it dhe vendorë i akuzuan tre persona për të cilët pohonin se e kishin sulmuar personelin dhe pronën që lidhet me ueb portalin *Kosova 2* gjatë një ndodhie në dhjetor të vitit 2012.

Dhuna dhe ngacmimi: Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK) raportoi për nëntë raste të abuzimit të lirisë së shtypit nga zyrtarë qeveritarë, grupe të interesit afarist, përfshirë sulmet fizike, kërcënimet verbale ndaj gazetarëve, presionin ndaj medieve për të mos publikuar materiale dhe artikuj dhe pengimin e punës së gazetarëve. Më 29 prill, p.sh.,

sulmues të panjohur me dhunë ia morën kamerën një ekipi të televizionit Klan Kosova që ishte duke xhiruar pamje nga ndërtimi i rrugës në Malishevë. Sulmuesit më pas i sulmuan dy gazetarët, të cilët kërkuan ndihmë mjekësore për shkak të lëndimeve të vogla fizike she stresit psikologjik. Policia arrestoi dy të dyshuar dhe rastin ua referoi prokurorëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës.

AGPK raportoi se shumë gazetarë ankoheshin që redaktorët nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë apo zyrtarë të caktuar për shkak të lidhjeve të redaktorëve apo të medieve me zyrtarë të lartë qeveritarë. Në disa raste, gazetarët raportonin që redaktorët i kërcënonin se do t'i largonin nga puna nëse vazhdonin të publikonin storje kritike për Qeverinë. Disa gazetarë u ankuan që redaktorët i ndaluan të publikonin storje për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Ndonëse nuk kishte raporte për censurim të drejtpërdrejtë të medieve të shkruara apo elektronike, gazetarët raportonin që presioni nga politikanët dhe krimi i organizuar shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo vendin e tyre të punës. Gazetarëve nganjëherë u ofroheshin përfitime financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi dhe zyrtarët qeveritarë dhe kriminelët e dyshuar gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetat që publikonin material kritik për to.

Interneti

Qeveria nuk e kufizoi qasjen në internet dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet pa autoritet përkatës ligjor. Individët dhe grupet mund t'i shprehnin mendimet përmes internetit, përfshirë e-mailat.

Pothuaj të gjitha zonat urbane kishin qasje të plotë në internet; kurse zonat rurale kishin më pak mbulesë. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit raportoi në gusht se 47 për qind e të gjitha shtëpive kishin lidhje interneti.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit dhe asociimit, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë. Ligji për tubime publike kërkon që organizatorët ta njoftojnë policinë për protesta 72 orë para ndodhisë. Policia duhet t'i njoftojë organizatorët brenda 48 orëve nëse protesta do të lejohet.

c. Liria e fesë

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi lirinë e fesë* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/g/drl/irf/rpt.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria e EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Megjithatë, tensionet ndëretnike, barrikadat e vendosura nga ekstremistët në veri dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes. Brengat e sigurisë gjithashtu penguan një numër të serbëve të Kosovës që kërkonin të ktheheshin.

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe grupeve të tjera të cenuara.

Policia e vlerësoi situatën e sigurisë si stabile, por të brishtë. Anëtarët e të gjitha bashkësive etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën.

Lëvizjet brenda vendit: Ekstremistët serbë të Kosovës në mënyrë sporadike vendosën barrikada në tërë Kosovën veriore, nganjëherë si reagim ndaj marrëveshjeve të arritura në dialogun Kosovë-Serbi të ndihmuar nga BE-ja. Barrikadat e kufizuan lëvizjen, shkaktuan vonesa në komunikacion për periudha të shkurta kohore dhe, në disa raste, krejtësisht e ndërprenë qasjen në zona të caktuara. Përveç kësaj, incidentet sporadike të dhunës dhe kërcënimit vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes në tërë vendin.

Udhëtimi jashtë vendit: Më 31 mars, sulmuesit sulmuan një autobus që udhëtonte nga Kosova për në Austri në pikën kufitare në Merdarë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sulmuesit gjoja bllokuan autobusin dhe filluan ta gjuanin me gurë. Vozitësi i autobusit, Qazim Berisha, shqiptar nga Kosova, i tha radios Evropa e Lirë që dy meshkuj e qëlluan me thikë kur doli nga autobusi dhe u ballafaqua me ta. Policia e Kosovës e konfirmoi këtë incident.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, numri i përllogaritur i personave të zhvendosur mbeti shumë i lartë. Në shtator kishte 17.523 persona në vend të regjistruar si të zhvendosur si pasojë e konfliktit të vitit 1998-99 dhe e dhunës së mëvonshme, përfshirë 9.535 serbë të Kosovës, 7.143 shqiptarë të Kosovës, 336 romë, 242 ashkalinj, 206 egjiptianë, dhe një numër të vogël të personave të përkatësive të tjera etnike. 359 familje, me gjithsej 930 anëtarë, ngelën në 37 strehimoret e vendit. Sipas Qendrës për monitorim të zhvendosjes brenda vendit, një numër i madh i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve (RAE) mbetën të paregjistruar dhe të panumëruar nga autoritetet. Shumë prej tyre jetonin në vendbanime joformale të cilave u mungonin rryma dhe shërbimet e tjera themelore.

Sipas një studimi për vlerësim të nevojave, të kryer nga Komisariati për Refugjatë i Serbisë dhe UNHCR-ja, rreth 97.000 persona të zhvendosur nga Kosova mbetën në Serbi.

Gjatë këtij viti, Ministria për Komunitete dhe Kthime ndau 6,5 milionë euro ($8,8 milionë) për ta lehtësuar kthimin e familjeve të zhvendosura nga armiqësitë dhe për t'u ofruar ndihmë. Donatorët ndërkombëtarë gjithashtu u siguruan mjete financiare drejtpërsëdrejti partnerëve zbatues të projekteve për kthime në koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthime. Autoritetet dhe partnerët zbatues i shpenzuan këto fonde në rindërtimin e shtëpive, ndihmë juridike, ushqim dhe gjëra joushqimore, në grante për gjenerimin e të ardhurave dhe mbështetje të infrastrukturës themelore, si të rrugëve dhe sistemeve të ujit. Mungesa e strehimit, ndarja e pamjaftueshme e tokës dhe kushtet e vështira ekonomike mbetën pengesat kryesore për kthim, posaçërisht për komunitetin RAE që nuk kishte tokë. Në pengesa të tjera përfshiheshin brengat e sigurisë, shërbimet e dobëta lokale dhe vështirësitë për riposedimin dhe rindërtimin e pronave të tyre. Personat e kthyer gjithashtu përballeshin me shkollim joadekuat në gjuhën serbe dhe shërbime joadekuat shëndetësore. Në disa komuna përfshirë Istogun, Mamushën, Gjakovën dhe Mitrovicën veriore, armiqësia e komunitetit ndaj anëtarëve të kthyer të pakicave, përfshirë kërcënimet për sigurinë personale, i dekurajonte kthimet.

Mbrojtja e refugjatëve

E drejta për azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit dhe Qeveria ka një sistem për t'u ofruar mbrojtje refugjatëve. Gjatë vitit, UNHCR-ja e ndihmoi Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim në ndërtimin e kapacitetit të vet për të gjykuar kërkesa. UNHCR-ja gjithashtu ofroi trajnim për gjyqësorin në mbrojtjen e refugjatëve ndërkombëtarë.

Sipas UNHCR-së autoritetet i ripranuan 2.638 persona që u kthyen në vend në tetë muajt e parë të vitit. Në këtë numër përfshihen 631 anëtarë të bashkësive pakicë që u kthyen pa dashje, shumica nga qeveritë e vendeve të Evropës perëndimore: 47 goranë, 18 boshnjakë, 15 serbë të Kosovës, 378 romë, 144 ashkalinj, 12 turq dhe gjashtë egjiptianë. 11 shqiptarë të Kosovës u vendosën në pjesë të vendit ku llogariteshin pakicë.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Sipas UNHCR-së, 51 azilkërkues paraqitën kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vend gjatë dhjetë muajve të parë të vitit. Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe qendra për azil i akomoduan të gjithë azilkërkuesit. Komisioni Kombëtar për Refugjatë i ofroi mbrojtje shtesë një kongolezeje pasi ajo kishte ushtruar ankesë ndaj refuzimit të mëparshëm.

Personat pa shtetësi

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Në tetë muajt e parë të vitit, UNHCR-ja u ndihmoi 1.300 personave për të marrë dokumente personale dhe për t'i zgjidhur çështjet e statusit civil në një përpjekje për ta parandaluar dhe zvogëluar numrin e personave pa shtetësi. Shumica e personave të ndihmuar ishin të komunitetit RAE që jetonin në Kosovë.

Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend.

Zbatimi i ligjit për gjendjen civile ndryshonte nga komuna në komunë, varësisht nga dallimet në kapacitet apo interpretimet e ndryshme të ligjit. Kapaciteti për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me kombësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Mungesa e dokumenteve të identitetit personal e pengonte përfshirjen shoqërore të komunitetit RAE duke i penguar për të pasur qasje në shërbime publike dhe i privonte nga mundësia për t'i mbrojtur të drejtat e veta politike, sociale dhe ekonomike. Anëtarët e paregjistruar të familjeve nuk merrnin ndihma sociale, nuk kishin të drejtë në pension dhe nuk kanë mundur të regjistrohen si titullarë të pronës apo të bartin të drejta mbi pronën e trashëguar apo të transferuar. Disa persona të kthyer vullnetarisht, si dhe fëmijët e ripranuar të lindur në qendra të zhvendosjes, hynë në vend pa certifikata të lindjes.

Në mars, Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme filloi heqjen e pagesës së taksave administrative dhe gjobave për shumë shërbime regjistrimi për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët e Kosovës. Lirimi nga këto taksa pritej të vazhdonte deri në mars të vitit 2014.

Seksioni 3. Respektimi i të drejtave politike: E drejta e qytetarëve për ta ndërruar Qeverinë e tyre

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore dhe qytetarët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike, të lira e të drejta, në bazë të votimit të përgjithshëm.

Qeveria serbe vazhdoi me shpërbërjen e strukturave paralele ilegale qeveritare në Kosovën veriore si pjesë e procesit të zbatimit të marrëveshjes së prillit për normalizim. Disa institucione paralele ilegale vazhduan të vepronin në enklavat serbe në tërë Kosovën në fund të vitit.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Autoritetet i mbajtën zgjedhjet lokale më 3 nëntor. Këto zgjedhje shënuan herën e parë që qytetarët e pjesës veriore të Kosovës votuan në zgjedhjet e administruara nga Kosova. Ndonëse Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë inkurajuan pjesëmarrjen e votuesve, ekstremistët apeluan për bojkotim dhe sulmuesit sulmuan tri vendvotime në veri, në Zveçan. Më 17 nëntor, Kosova administroi rivotimin në tri vendvotimet që ishin sulmuar. Raundi i dytë i zgjedhjeve në 25 komuna dhe rivotimi në tri vendvotime në Zveçan u mbajt më 1 dhjetor. Vëzhguesit ndërkombëtarë i cilësuan këto zgjedhje si zgjedhje me parregullsi minimale, ndonëse pasi disa raportime për kërcënim dhe mashtrim të votuesve.

Zgjedhjet nacionale për Kuvend në dhjetor të vitit 2010 dhe në janar të vitit 2011 u përcollën me parregullsi, manipulime zgjedhore dhe dështime teknike. Vëzhguesit vendës dhe ndërkombëtarë theksuan që zgjedhjet përmbushën shumë standarde ndërkombëtare, por vunë në pah parregullsi të mëdha, përfshirë shkeljen e procedurave zgjedhore, falsifikimin e nënshkrimeve në listën e votuesve dhe parregullsi në numërim. Ata raportuan për incidente të votimit familjar (kreu i familjes votonte në emër të femrave të familjes) në tërë vendin. Vëzhguesit gjithashtu cituan shembuj të presionit dhe kërcënimit ndaj vëzhguesve vendorë.

Në shkurt të vitit 2011, pas seancës konstituive, Kuvendi e zgjodhi Behgjet Pacollin President dhe e miratoi Qeverinë e re të koalicionit të drejtuar nga Partia Demokratike e Kosovës e Kryeministrit Hashim Thaçi.

Një gjykatë konstatoi që zgjedhja e Presidentit Pacolli nga Kuvendi shkeli Kushtetutën sepse nuk kishte kuorum të vlefshëm për ta mbajtur votimin dhe vetëm një kandidat garonte për zgjedhje. Gjykata e anuloi votimin e Kuvendit dhe menjëherë ia ndërpreu mandatin Pacollit. Më pas udhëheqësit politikë u pajtuan për një kandidat konsensual dhe, në prill të vitit 2011, Kuvendi e zgjodhi Atifete Jahjagën President. Palët e kushtëzuan marrëveshjen politike të vitit 2011 me hartimin e reformave kushtetuese për të ofruar zgjedhje të drejtpërdrejtë të presidentëve të ardhshëm nga elektorati dhe me reforma kuptimplote zgjedhore. Grupet punuese për reforma takoheshin nganjëherë gjatë vitit.

Partitë politike: Partitë politike vepronin pa kufizim apo ndërhyrje të jashtme. Lidhja partiake luante rol të madh në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të madh, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

Pjesëmarrja e femrave dhe pakicave: Ligji për zgjedhje kërkon që femrat të përbëjnë 30 për qind të parlamentarëve dhe 40 femra ishin në Kuvendin 120-anëtarësh. Një femër shërbeu si Presidente e vendit dhe dy femra ishin zëvendëskryeministre. Kryeministri emëroi dy femra ministre, njërën në Ministrinë e Integrimit Evropian dhe tjetrën në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Femra e parë për kryetar komune u zgjodh në balotazhin e mbajtur më 1 dhjetor.

Prej 25 anëtarëve të pakicave etnike që kishin vende në Kuvend, 13 ishin serbë të Kosovës. Të tjerët ishin turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Kushtetuta garanton 10 vende në Kuvend për serbët e Kosovës dhe 10 vende për anëtarët e grupeve të tjera të pakicave etnike.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Korrupsioni: Ligji parashikon dënime penale për korrupsion zyrtar; por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe thuhej që zyrtarët u përfshinë në praktika korruptuese gjatë vitit.

Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të raportuan që korrupsioni mbeti problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi. Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion të përhapur në Qeveri.

Në shtator, Zyra e Prokurorit njoftoi se i kishte shqyrtuar 2.307 raste të korrupsionit në të cilat ishin të përfshirë zyrtarë qeveritarë ndërmjet janarit të vitit 2012 dhe shtatorit të vitit 2013. Gjykatat i dënuan 187 persona me dënime me burg.

Më 27 shkurt, një prokuror i EULEX-it ngriti padi për korrupsion kundër kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja, dhe pesë zyrtarëve komunalë. Rasti përfshinte pohime për përdorim të paligjshëm të tokës që i takonte komunës dhe përfitim personal nga ajo.

Në korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës mbështeti shumicën e akuzave të ngritura në vitin 2012 kundër Fatmir Limaj, deputet i PDK-së, dhe të tjerëve për manipulim me procedura të

tenderimit, dhënie dhe marrje të ryshfetit dhe pengim të provave në lidhje me tre tenderë në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Dëmet që iu shkaktuan Qeverisë gjoja arritën shumën e përgjithshme rreth dy milionë euro (($2,7 milionë). Gjykata hodhi poshtë akuzat për përvetësim, lidhje të paligjshme të kontratës, shpëlarje të parave dhe posedim të paautorizuar të armëve, por konfirmoi një akuzë shtesë: mosdeklarimin e parave të pranuara për fushatë që ishin dhënë për Fatmir Limajn. Gjykimi pritej të mbahej në nëntor.

Më 29 prill, Gjykata Themelore e Prishtinës i dënoi pesë të pandehur në rastin Medicus për trafikim të organeve me 20 vjet burg për krime që përfshinin krimin e organizuar, trafikimin e njerëzve dhe lëndimet e rënda trupore. Lutfi Dervishi, drejtor dhe pronar i klinikës Medicus, u dënua me 8 vjet burg, një gjobë prej 10.000 eurosh dhe ndalim të ushtrimit të profesionit të urologut për dy vjet. I biri i tij, Arban Dervishi, u dënua me 7 vjet e tre muaj burg, dhe një gjobë prej 2.500 eurosh ($3.400). Gjykata u urdhëroi të dyve që t'ua paguanin të shtatë viktimave të trafikimit të organeve nga 15.000 euro ($20.000). Tre të pandehurit e tjerë morën dënime të ndryshme. Gjykata e liroi ish-Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Rrecaj (i cili pranoi gjatë gjykimit se ishte në dijeni për transplantim ilegal të veshkave në klinikën Medicus në vitin 2008, por mohoi ta kishte fshehur) nga akuza për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe falsifikim të dokumenteve. Rasti Medicus ishte i ndarë dhe nuk kishte lidhje me pretendimet e përfshira në Raportin e vitit 2010 të Këshillit të Evropës për *Trajtim Çnjerëzor të Njerëzve dhe Trafikim të Paligjshëm të Organeve Njerëzore në Kosovë*. Task Forca Speciale Hetuese e EULEX-it vazhdoi t'i hetonte këto pretendime në fund të vitit.

Korrupsioni mbeti problem në forcat e sigurisë.

Më 23 maj, një trup gjykues i Gjykatës Themelore të Pejës e shpalli ish-shefin e Task Forcës kundër Korrupsionit në Zyrën e Prokurorit Special të Kosovës, Nazmi Mustafi, fajtor për dy pika të akuzës: shpërdorim të pozitës zyrtare dhe posedim të paautorizuar të armës. Gjykata e dënoi me pesë vjet burg dhe një gjobë prej 10.000 eurosh ($14.000). Trupi gjykues i shpalli dy të pandehurit e tjerë, Reshad Zherkën dhe Xhelal Zherkën, fajtorë për ushtrim të ndikimit dhe nxitje për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe i dënoi me nga katër vjet burg dhe nga një gjobë prej 10.000 eurosh ($14.000). Gjykata konstatoi që Mustafi i kishte detyruar dy të pandehurit e tjerë t'i afroheshin të dyshuarve në dy raste që ai ishte duke i hetuar dhe të zhvatnin, apo të përpiqeshin të zhvatnin, para në shkëmbim për moslajmërim të rasteve kundër tyre.

Agjencia kundër Korrupsionit dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në Qeveri. Ndërmjet 1 janarit dhe 18 nëntorit, Agjencia kundër Korrupsionit kishte pranuar 180 raporte për korrupsion. Ata i referuan 60 raste për ndjekje penale, katër raste i kaluan polici, rreth 100 raste i mbyllën për shkak të mungesës së provave.

Mbrojtja e informatorëve: Ligji e mbron qytetarin apo punëtorin i cili, në mirëbesim, i raporton apo zbulon veprimet e paligjshme të zyrtarëve apo personave përgjegjës në institucione publike. Nuk pati raportime për persona që kërkonin mbrojtje sipas kësaj dispozite gjatë vitit.

Zbulimi financiar: Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Përveç kësaj, zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre në një funksion publik. Agjencia kosovare kundër Korrupsionit (AKK) administron regjistrin, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në uebfaqen e vet. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kritereve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. AKK ushtron kallëzime penale në raste më të rënda. Në vitin 2012, AKK inicioi raste për shkelje të vogla kundër 306 zyrtarëve të lartë publikë, që rezultuan në gjoba prej përafërsisht 140.000 eurosh ($190.000).

Gjatë vitit, ZAP auditoi shumicën e ministrive, përfshirë Zyrën e Presidentit dhe Kuvendin. ZAP kontrolloi menaxhimin dhe përgjegjësinë fiskale në Qeverinë qendrore, në administrata komunale dhe në ndërmarrje publike.

Qasja publike në informata: Ligji parashikon qasje publike në informata qeveritare dhe gjoba për institucione dhe zyrtarë që nuk ofrojnë qasje në informata siç kërkohet me ligj.

Qasja në dokumente publike është e drejtë e të gjithë qytetarëve dhe autoritetet ligjërisht mund t'ua mohojnë qasjen vetëm nëse zbulimi i tillë i cenon ose kërcënon interesat nacionale. Qytetarët individualë rrallë e përdorën këtë të drejtë. Organizatat e shoqërisë civile i parashtruan shumicën e kërkesave për informata. Gjatë vitit, organizatat e shoqërisë civile raportuan se institucionet qeveritare rrallëherë ua ofronin dokumentet që i kërkonin apo i njoftonin për kërkesat e tyre. Ato gjithashtu theksuan që gjykatat nuk i procedonin paditë që i kishin ushtruar kundër institucioneve që i kishin injoruar kërkesat e tyre për dokumente. Grupet e interesuara e konsideronin këtë mungesë të ndëshkimit si pengesë për efikasitetin e ligjit. Organizatat e shoqërisë civile raportuan se zyrtarët nganjëherë i refuzonin kërkesat e tyre mbi bazën që dokumentet përmbanin informata sekrete pa ia dhënë kërkuesit emrin e institucionit që i klasifikonte dokumentet apo numrin e rastit.

Në qershor, Instituti GAP njoftoi se kishte ushtruar dy padi civile kundër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik pasi ia kishte bllokuar qasjen në të dhëna lidhur me privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike. GAP nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga gjykata deri më 21 nëntor.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punuan pa kufizim, duke hetuar dhe publikuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria nganjëherë bashkëpunonte dhe u përgjigjej pikëpamjeve të tyre. Qeveria nganjëherë takohej me monitorues të OJQ-ve vendëse, u përgjigjej pyetjeve të tyre, apo ndërmerrte masa si përgjigje ndaj raporteve apo rekomandimeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejta të njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit ka kompetencë për t'i hetuar pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe shpërdorim të autoritetit qeveritar. Shumica e vëzhguesve të të drejtave të njeriut konsideronin që zyra ishte më e fuqishme se viteve të mëparshme, por jo plotësisht efikase. Avokati i Popullit rregullisht i vizitonte të gjitha komunat në vend dhe lëshonte deklarata publike pas ngjarjeve të rëndësishme.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, prejardhjes etnike, aftësisë së kufizuar, gjuhës, orientimit seksual apo statusit shoqëror. Qeveria nuk i zbatonte në mënyrë efikase këto ndalesa.

Femrat

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e konsideron dhunimin vepër penale, por nuk e trajton dhunimin bashkëshortor në mënyrë të posaçme. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg dhe dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me një fëmijë nën moshën 16-vjeçare) dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Dhunimi që përfshin vrasjen dënohet prej 10 vjet burg deri në burgim të përjetshëm. Vëzhguesit besuan që viktimat nuk raportuan në masë të madhe për dhunimin për shkak të turpit kulturor që u bashkëngjitej atyre dhe familjeve të tyre.

Ligji ndalon dhunën në familje dhe u lejon individëve që ndjehen të kërcënuar të paraqesin kërkesë për lëshim të urdhrit për mbrojtje. Dënimet me burg sillen prej 6 muaj deri në 5 vjet. Dhuna në familje ndaj femrave, përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji e trajton dhunën në familje si çështje civile, nëse viktima nuk ka pësuar lëndime trupore. Mosrespektimi i aktgjykimit të një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht. Thuhej që policia reagonte me vend ndaj pohimeve për dhunim dhe dhunë në familje. Policia dokumentoi tri vdekje nga dhuna në familje gjatë nëntë muajve të parë të vitit.

Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët dhe Prokuroria Speciale ua atribuonte këtë besnikërive familjare, varfërisë dhe numrit të rasteve të grumbulluara në gjykatat civile dhe penale. Dënimet silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara.

Qeveria ndërmori masa për t'i përmirësuar gjendjen lidhur me dhunën në familje dhe filloi zbatimin e Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për periudhën 2011-14, të cilin e miratoi në vitin 2011. Agjencia për Barazi Gjinore ishte përgjegjëse për zbatimin e ndryshimeve të politikave për ta luftuar dhunën në familje, duke propozuar një koordinator vendor dhe duke i ofruar Qeverisë raporte të rregullta. Shumë zyrtarë morën pjesë në ndodhi kushtuar individëve që ishin sulmuar seksualisht gjatë kohës së konfliktit në fund të viteve 1990-të.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale themeloi një njësi për t'u marrë vetëm me dhunën në familje. Ministria u siguroi pak përkrahje financiare OJQ-ve që drejtonin strehimore për viktima të dhunës në familje dhe të trafikimit dhe gjithashtu u ofroi shërbime sociale përmes qendrave për mirëqenie sociale. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave, por përpjekjet e tyre për t'i identifikuar dhe për t'u ndihmuar femrave mbetën të kufizuara për shkak të traditës së heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin

seksual dhe dhunimin. Një strehimore e sigurisë së lartë, e mbështetur nga Qeveria, u hap në dhjetor për t'i akomoduar viktimat, femra e meshkuj, të dhunës në familje dhe të trafikimit.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike përfshiu lëndë mbi dhunën në familje, dhunimin dhe trafikimin e personave në të gjitha programet e veta të trajnimit themelor. Autoritetet parapanë programe trajnimi për 212 kadetë të rinj gjatë vitit. Asociacioni i femrave në Policinë e Kosovës filloi së funksionuari në nëntor. Qëllimet e tij përfshinin avancimin e rolit të femrave në shërbim dhe krijimin e një rrjeti brenda policisë.

Ngacmimi seksual: Nuk ka ligj të posaçëm që trajton ngacmimin seksual. Sipas organizatave për të drejta të gruas, ngacmimi seksual në vend të punës ishte i rëndomtë dhe viktimat nuk e lajmëronin për shkak të frikës nga hakmarrja fizike apo largimi nga puna. Vetëdijesimi publik për ngacmim seksual mbeti i ulët.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin lirshëm dhe me përgjegjësi mbi numrin, shpeshtësinë dhe kohën kur të kenë fëmijë dhe mund ta bëjnë këtë pa diskriminim, detyrim dhe dhunë. Ligji mbron të drejtat riprodhuese të individëve dhe çifteve, përfshirë të drejtën për informim dhe qasje në shërbime riprodhuese. Qeveria në përgjithësi i respektoi të drejtat riprodhuese. Fondi i OKB-së për Popullatë (UNFPA) raportoi që qasja në informim dhe trajtim të shëndetit riprodhues ishte në përgjithësi e përhapur dhe e drejtë, por bashkësitë e varfra, të margjinalizuara dhe të pashkolluara shpesh kishin qasje të kufizuar në informata. Qendrat e kujdesit për shëndet publik ofronin trajtim të kufizuar për sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Diskriminimi: Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por statusi i tyre tradicionalisht më i ulët në familje ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit ka mandat për ta zbatuar dhe monitoruar Ligjin për barazi gjinore.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Femrat përbënin më pak se 30 për qind të fuqisë punëtore të Qeverisë. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, femrat posedonin më pak se 5 për qind të bizneseve të regjistruara në vitin 2012.

Ndonëse ligji nuk bën dallim në gjini lidhur me të drejtën për ta trashëguar pronën, prona e familjes zakonisht u kalohet vetëm meshkujve. Në raste të rralla, vejushat shqiptare të Kosovës, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa vejusha të kthehej në familjen e saj. Prova anekdotike sugjerojnë që disa të afërm rrejshëm i deklaronin vejushat jokompetente apo me aftësi të kufizuara mendore për t'ua marrë pronën.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend. Sipas një studimi të UNICEF-it të vitit 2008, 14 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në zonat e Kosovës me shumicë shqiptare nuk regjistroheshin kur lindnin. Në zonat e Kosovës me shumicë serbe, 5 për qind e fëmijëve nuk regjistroheshin siç duhej.

Mungesa e regjistrimit në përgjithësi nuk ndikonte në mundësinë e fëmijëve për shkollim fillor apo kujdes shëndetësor, por, sipas UNICEF-it, mund ndikonte negativisht në qasjen në ndihma sociale.

Abuzimi i fëmijëve: Përmasat e abuzimit të fëmijëve në vend nuk diheshin. UNICEF-i besonte që ky problem nuk raportohej sa duhej për shkak të mungesës së vetëdijesimit publik dhe shërbimit për viktima, si dhe mundësisë së kufizuar të autoriteteve për t'i identifikuar, raportuar dhe referuar rastet e abuzimit.

Martesa e detyruar dhe e hershme: Ligji lejon që personat të martohen ligjërisht në moshën 16-vjeçare. Pati prova anekdotike për martesë të fëmijëve, posaçërisht ndër bashkësitë rome, ashkalike, egjiptiane dhe shqiptare. Qeveria dhe OJQ-të nuk mblodhën të dhëna për martesën e fëmijëve.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Dhunimi i të miturës është vepër penale që dënohet prej 5 – 20 vjet burg, varësisht nga rrethanat dhe mosha e viktimës. Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personi që prodhon, përdor apo përfshin një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë dënohet prej një deri në pesë vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi nuk është nënshkrues i Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

Antisemitizmi

Më pak se 100 hebrenj jetonin në vend.

Vëzhguesit vërejtën një rritje në retorikën antisemitike, posaçërisht në internet. Në një postim në ueb të *Peace TV*, kryeredaktori Enis Rama bëri deklarime të shumta antisemitike, përfshirë "nuk ka qenie tjetër njerëzore, fis, klan apo racë që është më shkatërruese, më e keqe apo më ngatërrestare sesa hebrenjtë". Nën titullin, "Izraelitët e MPJ-së" (Ministrisë së Punëve të Jashtme), një gazetë lokale shkroi një editorial në shtator në të cilin e kritikonte ministrin e Punëve të Jashtme për punësimin e dy individëve, të cilët i perceptonin të jenë hebrenj.

Trafikimi i personave

Shih *Raportin* e Departamentit të Shtetit *mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/g/tip.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, qasje në kujdes shëndetësor dhe ofrim të shërbimeve të tjera shtetërore. Përkundër kërkesës ligjore që Qeveria t'u ofrojë mbrojtje dhe shërbime të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë, personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim të madh në praktikë. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase ligjet dhe programet për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara qasje në ndërtesa,

informata dhe komunikim. P.sh., personat me aftësi të kufizuara fizike nuk kishin qasje të lehtë në Zyrën e Avokatit të Popullit, ndonëse personeli i saj ishte përpjekur t'i akomodonte nevojat e personave të tillë, shpesh duke u takuar me ta në lokacione alternative. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji që përcakton të drejtat e personave të verbër hyri në fuqi në janar. Ai e rregullon statusin ligjor të personave të verbër dhe parashikon përfitime financiare.

Ligji parashikon mbrojtje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas Ministrisë së Arsimit, shtatë shkolla speciale u shërbenin fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, më 20 dhjetor, 453 fëmijë me nevoja speciale ishin në 77 klasë për fëmijë me nevoja speciale në shkolla të rregullta. Sipas UNDP-së, fëmijët me aftësi të kufizuara hasnin në një sërë pengesash për t'iu qasur objekteve të arsimit të rregullt, përfshirë mungesën e transportit, trajnimin e posaçëm për mësimdhënës dhe infrastrukturën përkatëse. Si rrjedhojë, vetëm 10 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara regjistroheshin në shkolla të rregullta. Ministrisë së Punës i mungonin mjetet financiare dhe personeli i duhur për t'i zbatuar ligjet dhe për t'u ofruar mbështetje familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Asnjë ligj nacional nuk e rregullon procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo mbron të drejtat e tyre brenda institucioneve të tilla. Objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde. Ministria e Punës dhe Ministria e Shëndetësisë kishin mandate të ndara për trajtimin e personave që merreshin me çështje të shëndetit mendor. QKRVT raportoi se, në raste të izoluara, policia i ndalonte personat me aftësi të kufizuara mendore pa kurrfarë baze ligjore. OBSH-ja vlerësonte se ishin 14.000 persona me aftësi të kufizuara mendore, por disa vëzhgues të tjerë vlerësonin që rreth 50.000 persona me aftësi të kufizuara mendore çonin jetë të izoluar dhe të stigmatizuar jashtë institucioneve.

Objekti kryesor për persona me aftësi të kufizuara mendore ishte Instituti Special i Shtimes (ISS), një kompleks me dy ndërtesa për trajtimin e personave. Njëra ndërtesë fokusohej në të rriturit me aftësi të kufizuara zhvillimore ose intelektuale dhe trajtonte 63 persona. Ndërtesa e dytë ishte e specializuar në trajtimin e të rriturve me probleme psikiatrike dhe kishte 65 persona gjatë vitit, shumica e të cilëve jetonin aty që nga lufta e vitit 1999. Qeveria gjithashtu mbështeti disa "shtëpi riedukimi" për persona me aftësi të kufizuara zhvillimore. Të gjitha, përveç njërës, u ishin dedikuar të rriturve me aftësi të kufizuara.

Ministria e Shëndetësisë drejtonte tetë shtëpi për integrim dhe riedukim anembanë vendit, të cilat u ofronin shërbime të kujdesit 75 personave me aftësi të kufizuara mendore. Ministria e Punës drejtonte 10 shtëpi të tjera për riedukim me nga 10 deri në 15 banorë. Shumica e banorëve gjoja kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u integruar në bashkësi.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Pakicat etnike, ku përfshiheshin bashkësia serbe, rome, ashkalike, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqoheshin me shkallë të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në fushat si punësimi, arsimi, shërbimet sociale, përdorimi i gjuhës, liria e lëvizjes, e drejta për t'u kthyer në shtëpi të veta (për persona të zhvendosur) dhe të drejta të tjera themelore. Anëtarët e bashkësisë rome, ashkalike dhe

egjiptiane vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik; shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim; dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Gjendja e sigurisë në veri mbeti e paparashikueshme dhe autoritetet raportuan për 43 incidente, përfshirë eksplodime, djegie të veturave dhe shkëmbim zjarri gjatë tre muajve të parë të vitit. EULEX-i dhe KFOR-i vazhdimisht ndërhynë për t'i penguar përleshjet ndërmjet grupeve etnike. Barrikadat në urën kryesore në Mitrovicë vazhduan ta pengonin lirinë e lëvizjes.

Task Forca e EULEX-it vazhdoi hetimet lidhur me plagosjen në qershor të vitit 2012 të dy ushtarëve gjermanë gjatë një operacioni për largimin e një barrikade në Rudarë.

Akte vandale dhe akte të tjera destruktive ndodhën gjatë janarit në varrezat ortodokse serbe që gjendeshin në tërë vendin. Policia arrestoi nëntë të dyshuar lidhur me këto incidente dhe suspendoi pesë policë. Organet shtetërore ndanë 97.000 euro ($130.000) për meremetimin dhe rindërtimin e varrezave të dëmtuara.

Serbët e Kosovës veriore vazhduan ta pengonin ndërtimin e shtëpive në lagjen Kroi i Vitakut për shqiptarët etnikë të cilët ishin zhvendosur nga ajo zonë në vitin 1999. P.sh., një grup prej rreth 50 serbëve të Kosovës bllokoi rrugën kryesore, duke ndalur ndërtimin.

Më 29 korrik, Policia e EULEX-it e arrestoi Zharko Vesellinoviqin në bazë të një urdhërarresti për rrezikim të personelit ndërkombëtar. Autoritetet e akuzuan Vesellinoviqin dhe një të dyshuar tjetër për tentimvrasje dhe përdorim të paautorizuar të armës në plagosjen në dhjetor të vitit 2012 të zëvendësshefit të Zyrës Administrative për Mitrovicën Veriore. Të njëjtën ditë, rreth 200 serbë protestuan kundër këtyre arrestimeve dhe bllokuan një rrugë. Kur policët e EULEX-it u përpoqën të bisedonin me protestues, sulmues të panjohur gjuan me gurë dhe ia thyen xhamin e përparmë një veture të EULEX-it. Më vonë atë natë, një koktej molotovi e dëmtoi lehtë një veturë të një polici polak, por nuk pati të lënduar.

Gjatë këtij viti, në pajtim me reformat e miratuara në vitin 2012, Qeveria emëroi një komisioner për gjuhët me orar të plotë për të ndihmuar në zbatimin e legjislacionit për statusin e barabartë për gjuhët zyrtare të vendit. Komisionari kishte për detyrë t'i monitoronte institucionet qeveritare dhe t'i gjobiste ato që nuk i respektonin ligjet. Ishte shumë herët për ta vlerësuar efikasitetin e saj në fund të vitit.

Në shkurt, Rrjeti Kosovar për Veprim Strategjik, që përfshinte mbi 100 OJQ në komunitetin e serbëve të Kosovës, mbajti një konferencë mbi problemet për zbatimin e ligjit për gjuhët. Prezantuesit pohuan që shumica e shkeljeve kishin të bënin me diskriminim kundër serbëve të Kosovës, posaçërisht me dështimin për ta përdorur alfabetin cirilik ose për t'i përkthyer drejt materialet përkatëse në gjuhën serbe.

Edhe përfaqësuesit e komunitetit turk shprehën pakënaqësi lidhur me zbatimin e ligjit mbi gjuhët, duke treguar raste kur materialet shkollore në gjuhën turke për nxënës të shkollës fillore mungonin ose ishin të përkthyera dobët.

Raportet për dhunë dhe krime të tjera të drejtuara kundër pakicave dhe pronës së tyre vazhduan. Në disa raste, granata dore u hodhën, ose u "mbollën", në pronën serbëve të Kosovës, dhe, së paku në një rast, shtëpia e një boshnjaku të Kosovës ishte cak.

Policët e Njësisë për Krime të Rënda nuk raportuan për përparim në identifikimin dhe arrestimin e të dyshuarve për vrasjen në korrik të vitit 2012 të një çifti të kthyer serb në shtëpinë e tyre në Talinoc.

Policia nuk identifikoi asnjë të dyshuar për sulmin në qershor të vitit 2012 ndaj murgut ortodoks serb, at Mitrofanit.

Disa incidente ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës ndodhën më 28 qershor, gjatë festës së Vidovdanit, ndonëse fërkimet mes këtyre dy komuniteteve ishin më pak shqetësuese sesa në vitin 2012. Në një incident, individë gjuajtën gurë në autobusët që i transportonin serbët e Kosovës që ktheheshin nga kremtimi i Vidovdanit. Një person pësoi lëndime të lehta në kokë dhe autorët thyen xhamat e autobusit. Policia ngriti kallëzim penal kundër katër të dyshuarve për lëndime të lehta trupore dhe dëmtim të pronës së luajtshme. Rasti mbeti nën hetime në nëntor.

Punësimi i pakicave në institucione publike mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të Qeverisë. Qeveria nuk pati mekanizma efektivë për monitorimin e niveleve të punësimit të pakicave në institucione publike.

Ligji kërkon kushte të barabarta për nxënës, pavarësisht nga gjuha amtare dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe disa organizata ndërkombëtare raportuan që shkalla e regjistrimit në shkollë ishte më e ulëta ndër bashkësitë pakicë jo-serbe (ashkalinj, boshnjakë egjiptianë, goranë, romë, turq dhe të tjerë). *Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2011* i Komisionit Evropian vërejti pak përmirësim në qasje në shkollim për bashkësitë pakicë. *Raporti* i UNDP-së *për Zhvillim Njerëzor në Kosovë 2010* konkludoi se pothuaj të gjithë fëmijët shqiptarë dhe serbë i vijonin mësimet në shkollë fillore, ndërsa vetëm 77 për qind e fëmijëve të grupeve të tjera etnike i vijonin mësimet. Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë dhe serbë të Kosovës dhe thuhej se përballeshin me kërcënim dhe ngacmim në disa zona me shumicë shqiptare. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre ta braktisnin shkollën dhe të fillonin të punonin që në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes.

Abuzimet shoqërore, diskriminimi dhe aktet e dhunës të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual.

Nuk pati diskriminim zyrtar në punësim, strehim, në të qenët pa shtetësi, në qasje në shkollim apo kujdes shëndetësor, por presioni shoqëror e detyroi pjesën më të madhe të LHBT-ve ta fshihnin orientimin e tyre seksual apo identitetin e tyre gjinor. OJQ-të raportuan që diskriminimi i drejtuar ndaj LHBT-ve shpesh kalonte pa u raportuar. OJQ-të gjithashtu theksuan se materialet e Qeverisë me të cilën mbështeteshin të drejtat e njeriut dhe praktikat

jodiskriminuese shpesh nuk i përmendnin të drejtat e LHBT-ve, madje edhe kur materialet i përmendnin qartazi të gjitha grupet e tjera të mbrojtura.

Në nëntor, Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut lëshoi një raport në të cilin thuhej që 40 për qind e LHBT-ve frikësoheshin ta tregonin identitetin e tyre dhe 10 për qind ishin sulmuar fizikisht së paku një herë si rezultat i të qenët LHBT.

Aktivistët LHBT, të prekur nga sulmi i dhjetorit të vitit 2012 në zyrën e OJQ-së së tyre, raportuan se zyrtarët i trajtonin me profesionalizëm dhe vazhdimisht i ndiqnin sulmuesit e tyre. Megjithatë, policia nuk kishte identifikuar asnjë të dyshuar deri më 1 tetor.

Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (QZHGSH), një OJQ vendëse e fokusuar në probleme shëndetësore, raportoi se LHBT-ët në përgjithësi ndjeheshin të pasigurt dhe shumë prej tyre raportonin kërcënime për sigurinë e tyre personale, por rrallëherë i raportonin incidentet tek autoritetet për shkak të njollës që i bashkëngjitej homoseksualizmit. Sipas QZHGSH-së, viktimat zakonisht refuzonin ta lejonin QZHGSH-në që t'i paraqiste rastet e tyre publikisht apo autoriteteve për shkak të frikës nga diskriminimi. Ndonëse QZHGSH nuk haste në pengesa të dukshme për punën e vet, presioni shoqëror dhe qëndrimet tradicionale ndikuan në kufizimin e veprimtarive të saj.

Qendra për Barazi dhe Liri raportoi se LHBT-ët që jetonin në zona rurale ballafaqoheshim me izolim ekstrem, disa deri në përmasën saqë nuk ishin në dijeni për të drejtat e tyre për të ekzistuar si LHBT apo për shërbimet që ishin në dispozicion për ta.

Qeveria ndërmori masa për të sinjalizuar mbështetjen e saj për të drejtat dhe problemet e LHBT-ve. Më 17 maj, Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë, p.sh., Qendra për Emancipim dhe Zhvillim Shoqëror sponsorizoi bashkë me Zyrën për Qeverisje të Mirë një konferencë të përbashkët për shtyp, të transmetuar në TV, për ta mbështetur tolerancën dhe respektimin e të drejtave të LHBT-ve. Më 11 dhjetor, Ministria e Integrimit Evropian mbajti një konferencë për ta ngritur mbështetjen për të drejtat e LHBT-ve si problem të të drejtave të njeriut.

Dhuna apo diskriminimi tjetër shoqëror

Ndonëse nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit, pati raportime anekdotike për diskriminim të tillë.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe t'iu bashkuar sindikatave të pavarura dhe të drejtën për të bërë grevë. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij sindikale. Ligji zbatohet njëlloj për të gjithë individët.

Autoritetet në përgjithësi e zbatuan ligjin.

Qeveria nuk e kufizoi të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht dhe u lejoi sindikatave të zhvillonin veprimtari, përfshirë grevat, pa ndërhyrje.

Qeveria në përgjithësi e respektoi të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave. Ndonëse pati të dhëna anekdotike që kompanitë private i kërcënonin punëtorët e vet kur u bashkoheshin apo themelonin sindikata, inspektorati i punës nuk pranoi asnjë ankesë për diskriminim nga punëtorët që përpiqeshin t'u bashkoheshin sindikatave gjatë vitit. Megjithatë, resurset, inspektimet dhe masat mbrojtëse ishin në përgjithësi joadekuate dhe gjobat nuk mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet.

Disa zyrtarë të sindikatës raportuan për diskriminim antisindikal. P.sh., Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) raportoi që disa kompani e pengonin themelimin e sindikatave. Sindikatat gjithashtu pohonin që të drejtat e punëtorëve shkeleshin në çdo sektor nga punëdhënësi, përfshirë organizatat ndërkombëtare, ku personeli gjoja nuk merrte pension.

b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar. Qeveria e zbatoi ligjin kundër punës së dhunshme apo të detyruar përmes vizitave që inspektorati i punës ua bënte punëdhënësve publikë apo privatë që merreshin me praktika të reja të punës ose që dyshohej se i përdornin fëmijët në kushte të rrezikshme, posaçërisht në sektorin e bujqësisë apo të minierave. Në qershor dhe korrik, Qeveria sponsorizoi një fushatë dymujore për ta ngritur vetëdijesimin publik për të drejtat e punëtorëve, për lypjen e detyruar dhe punën e dhunshme në sektorin e ndërtimtarisë.

Puna e dhunshme dhe e detyruar shpesh përfshinte fëmijët që detyroheshin të kërkonin lëmoshë dhe të punonin në kushte të rrezikshme (shih Seksioni 7.c.). Fëmijët merrnin pjesë në punë bujqësore dhe përdornin pajisje të rrezikshme.

Shih *Raportin e* Departamentit të Shtetit *mbi Trafikimin e Personave* në: www.state.gov/g/tip.

c. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punësim

Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet.

Rregulloret ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë punën e dhunshme apo të detyruar. Qeveria e mbështeti një task forcë kundër trafikimit, e cila filloi të ndërhynte në raste të punës së dhunshme apo të rrezikshme, por ishte e kufizuar për shkak të burimeve të pakta.

Në tetor, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e fëmijës si pjesë të masave të kërkuara për liberalizim të vizave me BE-në.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i koordinoi politikat e Qeverisë. Instituti i për politika sociale, i themeluar gjatë vitit, menaxhoi zbatimin e ligjeve për punën e fëmijës.

Ministria themeloi një sistem për monitorimin e incidenteve të punës së fëmijës në komuna, përfshirë zyrat komunale për punë dhe mirëqenie sociale, dhe në shkolla të largëta. Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur i gjenin të miturit duke punuar në kushte të rrezikshme. Megjithatë, ligji nuk zbatohej në mënyrë adekuate.

OJQ-të raportuan për shkelje të punës së fëmijës gjatë vitit. Fëmijët që punonin në sektorin e bujqësisë dhe të minierave hasnin në rreziqe që lidheshin me pajisjet për punë në bujqësi dhe nxjerrje të mineraleve nga vendet në të cilat arrihej me vështirësi. OJQ-të ndërkombëtare raportuan se numri i fëmijëve lypsarë në rrugë të qyteteve shënoi rënie viteve të fundit, por numri i përgjithshëm i fëmijëve lypsarë nuk dihej. Ndonëse shumica e fëmijëve rrallëherë ishin siguruesit kryesorë të të ardhurave për familje, puna e fëmijës shërbeu si kontribut i madh në të ardhurat e disa familjeve.

Në zonat rurale, fëmijët e rinj zakonisht u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore, zakonisht pas mësimit. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë, si dhe në ndërtimtari. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave.

Shih *Konkluzionet e* Departamentit të Punës *mbi format më të këqija të punës së fëmijës* në: www.dol.gov/ilab/programs/ocft/tda.htm.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Rroga minimale kombëtare ishte 130 euro ($180) në muaj për punëtorët nën moshën 35-vjeçare, dhe 170 euro ($230) në muaj për punëtorët mbi moshën 35-vjeçare. Programet për ndihmë sociale mund t'u ofronin familjeve pa burime të mjaftueshme deri në 80 euro ($110) në muaj, dhe një individ mund të merrte deri në 40 euro ($54) në muaj. Familjet dhe individët mund të merrnin fonde shtesë për fëmijë, të kishin zbritje në rrymë elektrike dhe beneficione të tjera.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagimin e bonusit për punën jashtë orarit, dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe tre muaj për pushim të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend.

Inspektorati i punës i Ministrisë së Punës i zbaton standardet e punës, shëndetit dhe sigurisë. Që nga 20 nëntori, 50 inspektorë të Inspektoratit të punës kryen 230 inspektime, këshilluan punëdhënës dhe shqiptuan 933 vërejtje për shkelje të ndryshme të standardeve të punës. Inspektorati shqiptoi 78 gjoba shtesë moskorrigjim të shkeljeve të cituara. Inspektorati vlerësoi se do t'i nevojiteshin 150 inspektorë për t'i monitoruar punëdhënësit në mënyrë adekuate ose për të ndikuar në zbutjen e problemeve të punës. Inspektorati i konsideronte gjobat financiare jo mjaft të larta për t'i dekurajuar shkeljet. Inspektorët zakonisht u jepnin punëdhënësve kohë të mjaftueshme për t'i korrigjuar shkeljet para se t'ua shqiptonin gjobat.

Qeveria nuk ofroi udhëzime për mbrojtjen e punëtorëve në ekonominë joformale.

Gjatë vitit, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës dhe pati mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. OJQ-të raportonin se punëtorët shpesh nuk i raportonin shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së tyre, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. Punëtorët raportonin për përjashtime nga puna pa arsye dhe në kundërshtim me ligjin dhe punëdhënësit refuzonin t'i respektonin festat e tyre. Organizata për të drejta të gruas treguan se ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim të ngjashëm, përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës për shkak të lidhjes me parti politike. BSPK gjithashtu raportoi se punëdhënësit nganjëherë në mënyrë të paligjshme i përjashtonin femrat nga puna për shkak se ishin shtatzënë ose kërkonin pushim të lehonisë.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe kushte të punës, institucionet private dhe publike nuk e respektonin atë nganjëherë. Zyrtarët e Inspektoratit të punës raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet vetë, edhe përkundër mbrojtjeve ligjore. Ministria e Punës raportoi për 12 fatalitete në vend të punës dhe 13 aksidente të rënda në vend të punës gjatë dhjetë muajve të parë të vitit.